



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 103, Datë 26.06.2019

MBI

**MIRATIMIN E TRANSPOZIMIT TË RREGULLORES 2017/459 TË MIRATUAR
ME VENDIMIN NR.2018/06/PHGL-ENC “MBI THEMELIMIN E KODIT TË RRJETIT
PËR MEKANIZMAT E ALOKIMIT TE KAPACITETEVE NË SISTEMET E
TRANSMETIMIT TË GAZIT”.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 44 të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar, parashikimeve të Vendimit nr. 2018/06/ PHGL - EnC datë 28.11.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 26.06.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi miratimin e transpozimit të rregullores 2017/459 të miratuar me vendimin nr.2018/06/PHGL-ENC “Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit te kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit”.

Konstatoi se:

- Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “ALBGAZ” sh.a. me shkresën nr.18 Prot., datë 18.02.2019, ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në ERE “Kodin e Rrjetit për mekanizmat e ndarjes së kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit”, të përditësuar dhe të përkthyer në gjuhën Shqip.
- Ky kod vjen për shqyrtim dhe miratim në ERE në përputhje me Ligjin 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, konkretisht neni 19, pika 5 dhe pika 8, neni 44, pika 1.
- Ky kod paraqitet e strukturuar në tetë seksione kryesore të parashikuara me dispozitat përkatëse në 38 nene dhe një shtojcë. Në mënyrë të përgjithshme ky kod krijon një kod të rrjetit që vendos mekanizmat e alokimit te kapaciteteve, duke pasur parasysh rregullat e përgjithshme tregëtare si dhe teknike lidhur me mekanizmat e alokimit te kapaciteteve. Pjesë integrale e kësaj rregulloreje për themelimin e kodit është edhe shtojca, e cila nëpërmjet tabelës përkatëse përcakton faktorët e konvertimit midis kushteve referencë.

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 44 të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", ERE ka kompetencën të miratojë propozimin për krijimin e “Kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit”.
- Ky draft është përshtatur në respektim të parashikimeve të dispozitave të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe parashikimeve të Vendimit nr. 2018/06/PHGL –EnC datë 28.11.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, duke dhënë orientim në lidhje me mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror.
- Në referencë të vendimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë PHLG- ENC, ky kod do të bëhet i detyrueshëm për të gjithë pjesmarrësit e tregut. Transpozimi do të bëhet pa ndryshime në strukturën e tekstit të Rregullores të Bashkimit Europian (EU) Nr.2017/460, përveç përkthimit dhe përshtatjes të bëre sipas këtij vendimi.
- Në kontekst të zbatimit të përgjegjësisë të monitorimit të zbatimit, Sekretariati do të monitorojë dhe analizojë, se si operatorët e sistemit të transmetimit, kanë zbatuar këtë Rregullore
 1. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet t'i dorëzojnë Sekretariatit të gjitha informacionet e kërkuara nga Sekretariati për të përmbushur detyrimet e tij sipas paragrafit 1, jo më vonë se 9 muaj pas skadimit të afatit për transpozimin e kësaj Rregulloreje
 2. Konfidencialiteti i informacionit komercialisht të ndjeshëm ruhet nga Sekretariati
 3. Jo më vonë se dy vjet pas skadimit të afatit për transpozimin e kësaj rregulloreje, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të raportojë mbi kushtet e parashikuara në kontratat për produkte të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar, duke pasur parasysh efektet e tyre në përdorimin efikas të rrjetit dhe integrimin e tregjeve të gazit të Komunitetit të Energjisë. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të mbështetet në vlerësimin e tij nga autoritetet kombëtare rregullore dhe operatorët e sistemit të transmetimit.
- Me shkresën me nr.32/14, datë 05.04.2019, ERE publikoi në median e shkruar njoftimin lidhur me fillimin e procedurave për shqyrtim të këtij akti nga ERE në mënyrë që ti mundesohej palëve të interesuara dhënien e komenteve apo opinioneve të mundshme lidhur me këtë akt, sipas afateve të përcaktuara në procedurën përkatëse.
- Gjithashtu me shkresën nr.298 prot, datë 11.04.2019, ERE i dërgoi palëve të interesit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; Autoritetit të Konurencës; Albpetrol sh.a; Albgaz sh.a vendimin e bordit të ERE-s nr.56, datë 03.04.2019 për të shprehur opinionet

mbi këtë draft brënda afateve të përcaktuara. Në përfundim të afateve për pritjen e komenteve apo opinionëve nga palët e treta rezultoi se nuk ka patur asnjë të tilla nga këto të fundit.

- Neni 1, pika 3 e Vendimit nr. 2018/06/ PHGL - EnC datë 28.11.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, përcaktohet se “*Ky Vendim do të bëhet i detyrueshëm për të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Transpozimi do të bëhet pa ndryshime në strukturën e tekstit të Rregullores të Bashkimit Europian (EU) Nr.2017/460 përveç përkthimit dhe përshtatjes të bërë sipas këtij vendimi*”.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Transpozimin e rregullores 2017/459 të miratuar me vendimin nr.2018/06/PHGL-ENC “Mbi themelimin e kodit të rjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit”.
2. Versioni në gjuhën e origjinës (Anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit Shqip
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI